VENDIM
Nr. 103, datë 18.8.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "LENGARICA & ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "LENGARICA" (ME FUQI TË INSTALUAR 8.94 MW)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa "a" të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 4, pika 1, germa "a", 5 pika 1, germa "a", 13 dhe 14 pika 1 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.8.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Lengarica & Energy"sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Lengarica & Energy" sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Lengarica" me fuqi të instaluar 8.94 MW, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti